



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 21.10.2021

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:
“RIKONSTRUKSION I LINJËS HEKURUDHORE DURRËS – TIRANË
DHE
NDËRTIM I LINJËS SË RE HEKURUDHORE
PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RINASIT”


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe ndërtim i linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit”, me subjekt zhvillues “Hekurudha Shqiptare” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë që do të shpronësohen;
 - b) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - c) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë, Bashkisë Krujë, Bashkisë Kamëz, Bashkisë Shijak, Bashkisë Vorë dhe Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i KKT-së Nr.06, datë 03.10.2018 “Për miratimin e lejes së ndërtimit të infrastrukturës: “Ndërtimi i Linjës Hekurudhore Durrës-Tiranë dhe i linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit”, me subjekt zhvillues “Hekurudha Shqiptare” sh.a., shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



A large, stylized handwritten signature in blue ink, written over the name and partially overlapping the official seal.



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA



A large, stylized handwritten signature in blue ink, written over the name and partially overlapping the official seal.

